



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.16.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR
KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur të Mediave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Selvete Foniqi (Anëtare e ekipit) , nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	14
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/02/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit të Pavarur të Mediave.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të KPM-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Mediave, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga KPM-ja kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare Nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Plani e prokurimit për vitin 2018; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të PFV-ve dhe kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi. Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në MF, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve tjera të kontrollit. Procedurat e prokurimit publik për KPM i ka zhvilluar Agjencia Qendrore e Prokurimi (AQP) siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP). Megjithatë, sfidë për institucionin edhe më tutje mbetet procesi i inventarizimit të pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	826,323	729,559	696,438	728,953	992,514
Granti i Qeverisë -Buxheti	826,323	729,559	696,438	728,953	992,514

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 96,764€, me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2018, KPM ka shpenzuar 696,438€ apo 95% të buxhetit final. Nivel të njëjtë të ekzekutimit kishte edhe në vitin 2017. Në përgjithësi, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	826,323	729,559	696,438	728,953	992,514
Pagat dhe Mëditjet	450,339	355,072	355,072	370,499	343,425
Mallrat dhe Shërbimet	347,984	347,984	318,144	331,650	339,752
Shërbimet komunale	28,000	26,503	23,222	26,804	16,693
Investimet Kapitale	-	-	-	-	292,644

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimet që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 95,267€, me vendimet të Qeverisë (Nr.02/70 të dt. 19.10.2018 për 94,664€ dhe vendimi Nr.07/80 i dt. 18.12.2018 për 603€) për kursime buxhetore. Kjo ishte si rezultat i mos rekrutimit të tetë (8) pozitive të reja të planifikuara;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime nuk kishte ndryshime me atë fillestar, ndërsa ishte shpenzuar 91%; dhe
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,496€ me vendim të Qeverisë Nr.07/80 të dt.18.12.2018, si kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit ishte 88%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

KPM realizon të hyra nga shërbimet mediale audio-vizuele nga këto burime, si: tarifa për aplikim të licencës, tarifat vjetore të licencës, tarifa për ndryshim dhe vazhdim të licencës si dhe gjomat.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	-	-	222,534	206,362	282,103
Totali	-	-	222,534	206,362	282,103

Të hyrat e realizuara për vitin 2018 ishin 222,534€, e që krahasuar me pranimet e vitin 2017 kishte një rritje prej 8%. Të hyrat e mbledhura ishin të hyrat nga licenca 214,194€ si dhe të hyrat nga gjomat në vlerë prej 8,340€ përfshirë pagesat nga vitet paraprake. Këto të hyra përmes llogarisë së KPM-së kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Në vitin 2018, shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 355,072€. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Komisionit të Pavarur për Media kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me Thesarin.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, avancimet, largimet, pushimet e lehonave, nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës) dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitet) në vitin 2018 ishte 374,487€, ndërsa ishin shpenzuar 341,366€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e qirasë, të mirëmbajtjes së paisjeve të monitorimit, të udhëtimit dhe akomodimit, shpenzime të mirëmbajtjes dhe sigurim i automjeteve dhe ndërtesës, shpenzime arsimit dhe trajnimit, shërbime të tjera kontraktuese si dhe shpenzime tjera. Për këto shpenzime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 495,622€, pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 21,774€ ndërsa stoqet 411€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Testet tona shpalosën çështjen si në vijim:

Çështja C 1² - Dobësi në procesin e inventarizimit të pasurisë

Gjetja

Neni 19 pika 4.7 i rregullores financiare nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, ka përcaktuar përgjegjësitë e komisionit për inventarizimin e pasurisë, ku njëra nga përgjegjësitë është hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së PVF. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Në raportin e përgjithshëm për inventarizimin e pasurisë, komisioni kishte raportuar se gjendja e pasurisë është e kënaqshme e në veçanti gjendja e pasurisë që përdoret nga stafi ishte vlerësuar e mirë.

Mirëpo, ne vërejtëm se në regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, tre asete³ ishin vlerësuar që janë jashtë përdorimit. Lidhur me këto, komisioni nuk kishte raportuar për gjendjen fizike të këtyre artikujve, për më tepër mungonin regjistrat individual të inventarizimit të pasurisë nga anëtarët e komisionit.

Kjo nuk ofron siguri se është bërë harmonizimi në mes të regjistrave individual të inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, për shkak se komisioni nuk ka qenë mirë i informuar me kërkesat e rregulloren 02/2013 mbi menaxhimin e pasurisë.

Rreziku

Raporti i komisionit për inventarizimin e pasurisë i cili nuk përmbledh informata të sakta për ekzistencën dhe gjendjen e pasurisë në dispozicion, rritë rrezikun që në regjistrat e pasurisë të prezentojnë evidenca jo të sakta dhe shpalosje jo të drejtë në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se anëtarët e komisionit për inventarizimin e pasurisë, paraprakisht janë të informuar për detyrat dhe përgjegjësitë, në mënyrë që raporti i inventarizimit të ofroj informata të sakta para përgatitjes së PVF.

² Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura nga viti i kaluar.

³ Një tavolinë, një orman dhe një pajisje e IT GPS.

3.3 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) e paraqitur në PVF ishte në vlerë 604,530€. Krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 59,291€ (545,239€ në vitin 2017) apo 11%. Prej totalit të paraqitur 78,160€ i takojnë vitit 2018, ndërsa pjesa tjetër i takon viteve paraprake që nga viti 2011.

KPM kishte ndërmarr masa për inkasimin e tyre duke proceduar lëndët në Gjykatën themelore për vitet 2011 deri 2013, ndërsa nga viti 2014 ato janë proceduar tek përmbaruesi privat.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 29,337€. Këto obligime kryesisht kanë mbet si pasojë e mbylljes së vitit fiskal pasi pranimi të tyre ishte bërë në fund të vitit 2018. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me rregulloren nr.02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KPM në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në KPM në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. KPM ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, kishte identifikuar disa rreziqe më evidente që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj si dhe ishte plotësuar pyetësi i vetëvlerësimit.

Megjithatë, mungesa e aprovimit të strategjisë gjithëpërfshirëse e KPM-së e përcjellur nga viti në vit, pastaj numri i vogël i stafit, duke mos lënë anash edhe infrastrukturën e kufizuar të ambientit punues, paraqesin sfidë për KPM-në në organizimin e brendshëm dhe funksionimin e saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA.nr.23/2009 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, KPM nuk i plotëson kriteret për themelimin e NJAB-së. Përkundër kërkesës që kishte bërë KPM-ja në Njësinë Qendrore Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave (MF) në dhjetor të vitit 2017, gjatë vitit 2018 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrur aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedojë raporte të rregullta.

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Lidhur me këtë, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja C2 - Mos aprovimi i planit strategjik

Gjetja Sipas Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave neni 3 “Kompetencat e KPM-së”, pika 1.1 ka definuar se KPM-ja përgatit Strategjinë për kalim në transmetim Digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike mediale audiovizuale për miratim nga Qeveria.

KPM në vitin 2015, fillimisht kishte dërguar për miratim në Qeveri “Strategjinë për Kalim në Transmetim Digjital në Republikën e Kosovës”, mirëpo nga Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) e ZKM-së është kërkuar që strategjia e KPM-së të sillet në përputhje me UA nr. 02/2012, lidhur me koston e saj. Pas kësaj, në muajin dhjetor të vitit 2017, KPM sërish ka dërguar në Qeveri për aprovim Strategjinë e rishikuar dhe të Harmonizuar në përputhje me kërkesat e ZKM-së, përkatësisht ZPS-së.

Përkundër kësaj, menaxhmenti i KPM-së ende deri më tani nuk ka marrë ndonjë opinion për aprovim apo mos aprovim të strategjisë nga Qeveria.

Rreziku Mos aprovimi i planit strategjik, pamundëson identifikimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara.

Rekomandimi C2 Kryetari i Komisionit duhet të kërkoj nga Zyra për Planifikim Strategjik arsyen e vonës në kthimin e përgjigjes apo mos dhënies së opinionit me shkrim nëse dokumenti i strategjisë mund të procedohet për miratim apo jo.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të KPM-së ka rezultuar në gjashtë rekomandime. Për këto, KPM kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, katër rekomandime janë zbatuar ndërsa dy ishin pjesërisht të zbatuara. Rekomandimet pjesërisht zbatuara kanë të bëjë me dobësitë në procesin e inventarizimit dhe mos aprovimit të planit strategjik për transmetim digjital. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pagat dhe mëditjet	Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen se marrëveshjet për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, të planifikohen drejtë dhe të bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.	Në vitin 2018 nuk ka kontraktuar shërbime të veçanta.	I zbatuar.
2	Pagat dhe mëditjet	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojnë se në rastet e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, kompensimet të bëhen në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe të siguroj vendosjen e kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.	Nuk ka pasur raste të ngjashme.	I zbatuar.
3	Menaxhimi i personelit	Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen zhvillimin e procedurave të rekrutimit që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.	Nuk ka pasur tejkalim të afateve për pozitat e mbuluara me UD, njëherit. Pozita e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Publikun është rekrutuar gjatë vitit 2018 me kontratë të rregullt.	I zbatuar.
4	Mallra dhe Shërbime	Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen se nuk do të realizojnë pagesa para se të konfirmohet se shërbimet e trajnimit janë kryer. Pagesave nga mallrat dhe shërbimet duhet ti paraprin një marrëveshje ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe të jenë në pajtim me ligjin e buxhetit dhe rregulloret në fuqi.	Testimet tona nuk kane indentifikuar raste të ngjashme si në vitin e kaluar.	I zbatuar.
5	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari i Komisionit duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionin për vlerësim të pasurive në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive si dhe të konfirmojnë shkallën e tyre funksionale/të përdorimit. Rezultatet e raporteve përfundimtare duhet të shqyrtohen nga KPM dhe të pasohen me regjistrimet e nevojshme kontabël përputhje me kërkesat rregullative.	KPM ka aplikuar sistemin e-pasuria për regjistrimin e stoqeve, mirëpo edhe këtë vit kemi indentifikuar dobësi në raportin e komisionit të inventarizimit.	Pjesërisht i zbatuar.

6	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut.	Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen aprovimin e strategjisë për transmetim digjital në Republikën e Kosovës dhe analizim më të detajuar të rreziqeve me të cilat përballet KPM.	KPM kishte përgatitur regjistrin e detajuar të rreziqeve, mirëpo edhe më tutje nuk kishte arritur të sigurojë aprovimin e strategjisë nga Qeveria.	Pjesërisht i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se anëtarët e komisionit për inventarizimin e pasurisë, paraprakisht janë të informuar për detyrat dhe përgjegjësitë, në mënyrë që raporti i inventarizimit të ofroj informata të sakta para përgatitjes së PVF.		
2	Qeverisja e mirë	Kryetari i Komisionit duhet të kërkoj nga Zyra për Planifikim Strategjik arsyen vonesës në kthimin e përgjigjes apo mos dhënies së opinionit me shkrim nëse dokumenti i strategjisë mund të procedohet për miratim apo jo.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Muja Ferati

Kryetar i Komisionit të Pavarur të Mediave

Data: 29 mars 2019, Prishtinë,

